



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 255 Prot.

Tiranë, më datë 05.07.2024

**VENDIM**

**Nr. 223, datë 05.07.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 05.07.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Konceptit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “*Godinë banimi & shërbimi 3-5 kat+1 kat nën tokë*”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B" Durrës, me zhvillues **Z. Artan Cani dhe Znj. Entela Cani**;
  2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike në kuadër të projektit “*Godinë banimi & shërbimi 3-5 kat+1 kat nën tokë*”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B" Durrës, me zhvillues **Z. Artan Cani dhe Znj. Entela Cani**, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
  3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shyrtim dhe vendimmarje në KKTKM;
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Sokol ISMAILI**

**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**